



VENDIM

Nr. 770, datë 12.11.2014

**PËR KALIMIN NË FONDIN E
KOMPENSIMIT FIZIK, NË
DISPOZICION TË AGJENCISË SË
KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË
PRONAVE, TË SIPËRFAQES SË TOKËS
BUJQËSORE PREJ 23 368.8 HA, NË
PRONËSI SHETETËRORE, DHËNË NË
PËRDORIM NJËSIVE TË QEVERISJES
VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të shkronjës “b”, të nenit 14, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe shkronjës “c”, të nenit 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në fondin e kompensimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23 368.8 (njëzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë tetë) ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim njësive të qeverisjes vendore, sipas listës dhe materialit hartografik digjital, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Njësitë të qeverisjes vendore u shfuqizohet e drejta e përdorimit për pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe këshillat e qarqeve Elbasan, Korçë, Berat dhe Gjirokastrë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama







